


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Shkurt, 2018

Tiranë, më 8 Mars 2018: Në muajin Shkurt 2018 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2,1 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 2,2 %.

Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit të muajit Shkurt 2018, krahasuar me Janar 2018, është 0,8 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Shkurt është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,03 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,62 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me +0,14 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me +0,11 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shërbimi arsimor”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili.

Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje.

Për publikim 08/03/2018

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shkurt 2017, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 3,1 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 2,9 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2,7 %, “Transporti” me 2,3 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,6 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,7 %, “Shërbimi arsimor” me 0,6 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 17,8 %, pasuar nga nëngrupet “peshk” me 5,9 %, “zarzavate përfshirë patatet” me 4,0 %, etj. Nga ana tjetër çmimet e nëngrupit “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” u ulën me 1,8 %.

Ndryshimi mujor i indeksit është +0,8 %. Krahasuar me muajin Janar 2018 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike me 2,0 %, pasuar nga grupet “Komunikimi” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,4 % secili. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” shënuan një ulje prej 0,6 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18
	Gjithsej	100	104,3	104,7	104,0	102,8	102,4	102,3	102,7	103,1	103,1	103,0	104,0	105,6	106,4
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	38,6	110,1	110,6	109,1	106,2	105,5	105,1	106,2	106,7	106,5	105,7	107,5	110,8	113,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,5	101,4	101,7	101,9	101,7	101,7	101,6	101,6	101,6	101,5	101,7	101,8	102,9	103,0
3	Veshje dhe këpucë	4,1	97,6	97,7	96,0	96,4	95,8	96,4	96,0	98,3	99,9	100,2	101,5	101,0	100,4
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	101,3	101,8	101,5	101,4	101,4	101,4	101,4	101,5	101,6	102,0	103,1	104,4	104,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,1	100,1	99,9	99,9	99,9	99,8	99,4	99,5	99,4	99,5	99,7	100,2	100,1	100,3
6	Shëndeti	3,0	100,3	100,2	100,1	100,2	100,1	100,1	100,0	100,0	100,0	100,4	100,3	100,3	100,3
7	Transporti	6,0	98,9	99,9	100,4	99,7	99,3	99,7	100,2	100,3	100,0	101,3	101,2	101,2	101,1
8	Komunikimi	2,8	100,2	100,2	100,5	100,5	100,5	100,5	100,5	100,4	100,4	100,7	100,8	100,8	101,2
9	Argëtim dhe kulturë	2,6	103,0	103,3	104,7	102,2	101,5	100,6	100,3	102,5	103,3	101,8	102,3	102,4	102,8
10	Shërbimi arsimor	3,1	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,7	100,9	101,3	101,3	101,3	101,3	101,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,8	100,2	100,2	100,2	100,2	100,1	100,1	100,1	100,1	100,1	100,2	100,6	100,7	100,8
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	103,2	103,5	103,3	103,3	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4	103,4	103,5	103,6	103,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	02-17/02-16	03-17/03-16	04-17/04-16	05-17/05-16	06-17/06-16	07-17/07-16	08-17/08-16	09-17/09-16	10-17/10-16	11-17/11-16	12-17/12-16	01-18/01-17	02-18/02-17
	Gjithsej	2,2	2,1	1,9	2,0	2,2	2,0	1,6	1,6	1,9	1,7	1,8	1,7	2,1
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,9	3,3	3,0	3,8	5,1	4,7	3,3	3,5	4,0	3,7	2,8	2,2	2,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,6	0,5	1,0	0,8	0,8	0,7	0,7	0,6	0,4	0,9	0,5	1,5	1,6
3	Veshje dhe këpucë	-0,4	-0,7	-2,3	-2,1	-2,5	-1,7	-2,1	-1,6	-0,4	-0,4	0,6	1,1	2,9
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,6	1,1	0,9	0,9	0,9	1,1	1,1	1,1	1,1	0,6	2,2	3,3	3,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,2	-0,1	-0,3	-0,4	-0,5	-1,1	-0,9	-0,8	-0,2	-0,5	0,0	-0,2	0,2
6	Shëndeti	0,2	0,1	-0,1	0,2	-0,1	0,0	0,1	-0,2	0,0	0,2	0,1	0,1	0,1
7	Transporti	3,2	3,8	4,3	2,6	0,7	0,4	0,4	0,8	0,4	1,9	2,1	1,8	2,3
8	Komunikimi	0,2	-0,1	0,6	0,6	0,5	0,6	0,6	-0,1	0,0	0,0	0,2	0,6	1,0
9	Argëtim dhe kulturë	2,8	3,2	4,5	2,0	0,6	-1,1	-1,1	0,8	2,1	0,8	-0,1	-0,8	-0,2
10	Shërbimi arsimor	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	0,7	1,0	0,9	0,5	0,6	0,6	0,6
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,2	0,2	0,1	0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,2	0,5	0,7	0,7
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,0	3,4	3,1	3,0	3,2	3,4	3,0	0,1	0,2	0,3	0,2	0,3	0,4

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	02-17	03-17	04-17	05-17	06-17	07-17	08-17	09-17	10-17	11-17	12-17	01-18	02-18
	Gjithsej	0,5	0,4	-0,6	-1,2	-0,3	-0,1	0,4	0,4	0,04	-0,1	1,0	1,5	0,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,5	0,5	-1,4	-2,7	-0,7	-0,3	1,0	0,5	-0,1	-0,8	1,8	3,1	2,0
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,0	0,3	0,2	-0,2	0,1	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,2	0,1	1,1	0,1
3	Veshje dhe këpucë	-2,3	0,1	-1,7	0,3	-0,5	0,6	-0,4	2,4	1,6	0,3	1,3	-0,5	-0,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,2	0,5	-0,3	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1	0,4	1,0	1,3	0,0
5	Mobiliile, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	-0,2	0,0	0,0	-0,1	-0,4	0,1	-0,1	0,1	0,2	0,5	-0,1	0,2
6	Shëndeti	0,0	0,0	-0,1	0,1	-0,1	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,4	-0,1	0,0	0,0
7	Transporti	-0,5	1,0	0,5	-0,7	-0,4	0,4	0,5	0,1	-0,3	1,3	-0,1	0,0	-0,1
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,2	0,0	0,4
9	Argëtim dhe kulturë	-0,3	0,4	1,3	-2,4	-0,7	-0,9	-0,3	2,2	0,8	-1,5	0,5	0,2	0,4
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,2	0,3	0,0	0,1	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,1	0,0	0,0	0,0	-0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,4	0,2	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,3	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0

Shpjegime metodologjike

- Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjise ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2016.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Kjo listë nuk ka ndryshime me vitin e kaluar, shporta përbëhet nga 332 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

- Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.